

## **SYLLABUS i Lëndës: E drejta E Pronësisë**

| <b>Të dhëna bazike të lëndës</b>        |  |
|---|--|
| <b>Njësia akademike:</b>                | <b>Fakulteti Juridik</b>   |
| <b>Titulli i lëndës:</b>                | <b>E drejta Komerciale ne BE dhe disa vende ne Rajon</b>   |
| <b>Niveli:</b>                          | <b>Master</b>  |
| <b>Statusi lëndës:</b>                  | <b>Zgjedhore</b>   |
| <b>Viti i studimeve:</b>                | <b>I/Master</b>  |
| <b>Numri i orëve në javë:</b>           | <b>2+1</b>   |
| <b>Vlera në kredi – ECTS:</b>           | <b>5</b>   |
| <b>Koha / lokacioni:</b>                | <b>/</b>   |
| <b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>           | <b>Prof. Dr. Haxhi Gashi<br/>Ma.Sc. Qerkin Berisha</b>   |
| <b>Detajet kontaktuese:</b>             | <a href="mailto:haxhi.gashi@uni-pr.edu">haxhi.gashi@uni-pr.edu</a><br><a href="mailto:qerkin.berisha@uni-pr.edu">qerkin.berisha@uni-pr.edu</a>   |
| <b>Përshkrimi i lëndës</b>              |  |
|   | Kjo lëndë synon që të ofrojë njohuri për student lidhur me të drejtën komerciale në BE. Me gjerësisht në këtë lëndë mësohet për Burimet e së Drejtës Komerciale në BE lidhur me të drejtën komerciale, tregu i lirë Evropian, konkurrenca, ndihme shtetërore, zgjidhja e rasteve nga Gjykata e Drejtës së BE-së.   |
| <b>Qëllimet e lëndës:</b>               |  |
|   | Qëllimi i kursit është ofrimi i njohurive ligjore dhe praktike për studentët se si të kuptohen më mirë 1) Funksionimi i BE-së në fushën komerciale përfshirë edhe institucionet përgjegjëse 2) Aktet Ligjore të BE-së në fushën komerciale, 3) Zbatimi i ligjeve të BE-së në shtetet anëtare në fushën komerciale 4) zgjidhja e rasteve nga Gjykata E drejtësisë e BE-së që lidhen me shkeljen e ligjeve të BE-së.   |
| <b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b> |  |
|   | Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të aftësohen për kryerjen e veprimeve si në vijim: <ol style="list-style-type: none"><li>1. Të jenë në gjendje për të marrë njohurit themelore se si është themeluar Bashkimi Evropian dhe në veçanti Bashkimi Ekonomik Evropian;</li><li>2. Cilat janë Aktet ligjore të BE-së në fushën komerciale;</li><li>3. Tregu i lirë Evropian dhe eliminimi i barrierave ekonomike në mes shteteve anëtare.</li><li>4. Zbatimi i akteve ligjore, primare dhe sekondare (Traktateve, Direktivave, Rregulloreve etj) në</li></ol> |

|  |   |
|--|---|
|  | <p>vendet anëtare të BE-së.</p> <p>5. Të përdorë metodat më adekuate më qëllim të studimeve krahasuese në fushën e të drejtës komerciale dhe zgjidhjen e rasteve të shkeljes së të drejtës së BE-së nga shtetet anëtare.</p> <p>6. Perspektiva e Kosovës në fushën e të drejtës komerciale në BE- dhe zbatimi i standardeve të BE-së në Kosovë.</p> |
|--|---|

| <b>Kontributi në ngarkesën e studentit ( gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxëniet të studentit)</b> |               |                  |                  |
|--|---------------|------------------|------------------|
| <b>Aktiviteti</b>  | <b>Orë</b>    | <b>Ditë/javë</b> | <b>Gjithësej</b> |
| Ligjërata  | 2             | 1/15             | 30               |
| Ushtrime teorike/laboratorike  | 1             | 1/15             | 15               |
| Punë praktike  | 1             | 1/15             | 15               |
| Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet   | 1             | 1/15             | 15               |
| Ushtrime në teren  | 1             | 1/15             | 15               |
| Kollokfiume,seminare   | 2             | 2/5              | 10               |
| Detyra të shtëpisë   | 2             | 1/5              | 10               |
| Koha e studimit vetanëk të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)   | 2             | 1/15             | 15               |
| Përgaditja përfundimtare për provim  | 2             | 1/5              | 10               |
| Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)  | 5             | 1/1              | 5                |
| Projektet,prezentimet ,etj   | 10            | 1/1              | 10               |
| <b>Totali</b>  | <b>5 ECTS</b> | <b>Total</b>     | <b>150</b>       |

|                                     |   |
|-------------------------------------|---|
| <b>Metodologjia e mësimdhënies:</b> | <p>Kursi do të organizohet përmes ligjëratave, seminareve dhe shqyrtimin e rasteve</p> <p><i>Ligjëratat:</i> mbajtja e ligjëratave do të bëhet në forme gojore e përcjell me power point, interaktive – bashkëbisedim me studentët, diskutim i çështjeve praktike dhe ligjërata.</p> <p><i>Seminaret:</i> çdo studentë duhet të punoj një punë kërkimore-shkencore që do të prezantohet përmes seminarit. Seminari duhet të jetë në mes 8 dhe 10 faqe, formati A4, formati i shkronjave fonti- time new roman, madhësia 12, hapësira 1.5. Çdo seminar duhet të ketë temën e trajtimit e cila formohet në formë të hipotezës apo pyetjes së hapur e cila duhet ta gjejë përgjigjen e qartë në përmbajtjen e seminarit me theks të veçantë në konkluzion. Tema e seminarit caktohet në konsultim me profesorin. Seminari duhet të përbëj një punë të pavarur shkencore dhe e shoqëruar me referenca (fushnotë) të qarta dhe çdo kopjim ose plagjiaturë, do të reflektohet</p> |
|-------------------------------------|---|

|  |   |  |  |
|--|---|--|--|
|  | <p>me vlerësim negativ në vlerësimin përfundimtar.</p> <p><i>Raste studimi-simulimi:</i> gjatë kursit studentët do të kenë punë praktike të cilat do të jenë në formën e rasteve të studimit që mbahen në klasë. Studentët do të ngarkohen edhe me raste studimi të cilat duhet të punohen në si detyrë shtëpie dhe të sjellën te profesori në kohën e kërkuar. Rastet e studimit përbëhen nga formulime me shkrim të rasteve nga praktika dhe dhënia për detyrë studentëve për të zgjidhur rastin e tillë në pajtim me dispozitat ligjore. Simulimi i rasteve paraqet formë praktike përmes së cilës studentët aftësohen në ushtrime praktike duke simuluar raste dhe marrë rolin e palëve dhe organeve tjera në çështje krahasuese të drejtës komerciale në BE.</p>   |  |  |
|  |   |  |  |
| <b>Metodat e vlerësimit:</b>   | <p>Vlerësimi do të bëhet përmes pjesëmarrës, angazhimit në seminar, angazhimit në rast të studimit, dhe provimi përfundimtar.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Pjesëmarrja e studentëve</i> 10%</li> <li>- <i>Seminari</i> 10%</li> <li>- <i>Rasti i studimit</i> 20% (10% rastet e studimit në klasë dhe 10% rastet e studimit detyrë shtëpie)</li> <li>- <i>Provimi përfundimtar</i> 60% (provimi përfundimtar organizohet në formë me shkrim i cili përbëhet nga 50% e pikëve pyetje alternative dhe të hapura, 25% ese dhe 25% rast i shkurtër studimi. Kalueshmëria me 60% e pikëve të fituara).</li> </ul> <p><b><u>Ndërtimi i notës:</u></b></p> <table style="width: 100%; border: none;"> <tr> <td style="width: 50%; vertical-align: top;"> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>%</b></li> <li>• 91-100</li> <li>• 81-90</li> <li>• 71-80</li> <li>• 61-70</li> <li>• 51-60</li> </ul> </td> <td style="width: 50%; vertical-align: top;"> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Nota</b></li> <li>• 10 (dhjetë)</li> <li>• 9 (nëntë)</li> <li>• 8 (tetë)</li> <li>• 7 (shtatë)</li> <li>• 6 (gjashtë)</li> </ul> </td> </tr> </table> | <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>%</b></li> <li>• 91-100</li> <li>• 81-90</li> <li>• 71-80</li> <li>• 61-70</li> <li>• 51-60</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Nota</b></li> <li>• 10 (dhjetë)</li> <li>• 9 (nëntë)</li> <li>• 8 (tetë)</li> <li>• 7 (shtatë)</li> <li>• 6 (gjashtë)</li> </ul> |
| <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>%</b></li> <li>• 91-100</li> <li>• 81-90</li> <li>• 71-80</li> <li>• 61-70</li> <li>• 51-60</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Nota</b></li> <li>• 10 (dhjetë)</li> <li>• 9 (nëntë)</li> <li>• 8 (tetë)</li> <li>• 7 (shtatë)</li> <li>• 6 (gjashtë)</li> </ul>  |  |  |
| <b>Literatura</b>  |   |  |  |
| <b>Literatura bazë:</b>  | <ul style="list-style-type: none"> <li>- Cyril Nourissat, E Drejta e Biznesit e Bashkimit Evropian, Dalloz 2010 ‘‘Droit des affaires de l’Union europeene’’, përkthim në gjuhën shqipe, Papyrus 2012, Tiranë</li> <li>- Blerim Reka, Otmar Holl, Ylber Sela, Institucionet dhe Politikat e Unionit Evropian, Tetovë, 2010, faqe- 1-53, 78-138, 168-183</li> <li>- Bashkim Zahiti, E Drejta Evropiane, Prishtinë, 2013, faqe 8-28, 41-46, 94-142, 157-206,</li> </ul>  |  |  |
| <b>Literatura shtesë:</b>  | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Catherine Barnard, <i>The Substantive Law of the EU: the Four Freedoms</i> (3rd end 2010)</li> </ul>   |  |  |

|  |   |
|--|---|
|  | <ul style="list-style-type: none"> <li>• Paul Craig and Gráinne de Búrca, <i>EU Law: Text, Cases, and Materials</i> (5th end 2011)</li> <li>• Alison Jones and Brenda Sufrin, <i>EU Competition Law: Text, Cases, and Materials</i> (4th end 2010)</li> <li>• Gabriël Moens and John Trone, <i>Commercial Law of the European Union</i> (2010)</li> </ul> |
|--|---|

### Plani i dizajnuar i mësimit:

| Java                         | Ligjerata që do të zhvillohet                                       |
|------------------------------|---|
| <i>Java e parë:</i>          | - Themelimi i Unionit Evropian                                      |
| <i>Java e dytë:</i>          | - Institucionet Politike të BE-së                                   |
| <i>Java e tretë:</i>         | - Parimet e të Drejtës së BE-së në të drejtën komerciale            |
| <i>Java e katërt:</i>        | - E drejta Komerciale   |
| <i>Java e pestë:</i>         | - Tregtia e lirë  |
| <i>Java e gjashtë:</i>       | - Ligjet e konkurrencës   |
| <i>Java e shtatë:</i>        | - Ndihma shtetërore   |
| <i>Java e tetë:</i>          | - Prokurimi Publik  |
| <i>Java e nëntë:</i>         | - Të drejtat e pronësisë industriale dhe komerciale                 |
| <i>Java e dhjetë:</i>        | - Propozimet për një Ligj të tregtisë së BE-së                      |
| <i>Java e njëmbëdhjetë:</i>  | - E drejta kontraktore në BE  |
| <i>Java e dymbëdhjetë:</i>   | - Shqyrtimet gjyqësore të rasteve nga Gjykata e Drejtësisë së BE-së |
| <i>Java e trembëdhjetë:</i>  | - E drejta pronësore në BE dhe përpjekjet për një Kod Civil në BE   |
| <i>Java e katërmëdhjetë:</i> | - përmbledhje, diskutime dhe evaluimi i kursit                      |
| <i>Java e pesëmbëdhjetë:</i> | - Testi Final   |

### Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

#### Integriteti akademik:

Gjate procesit mësimor dhe atij te vlerësimit te studentëve përfshirë edhe kontaktet tjera me student qe ndërliiden me raportet studimore, mesimdhënesi duhet te ruaj integritetin e tij akademik dhe te tregoj vlera te larta morale dhe njerëzore si dhe te jete i paanshëm dhe te jete ne gjendje qe te përballlet me çdo sfide ne këtë drejtim nga çdo ndikim apo presion qe mund t'i behet nga te tjerët. Studentet janë te obliguar t'i përmbahen rregullave te mirësjelljes si gjate ligjëratave, ushtrimeve dhe provimit, në të kundërtën mund të rrezikojnë të jenë palë në procedurat disiplinore sipas rregullave të Fakultetit Juridik dhe rregullave të Universitetit të Prishtinës.

Plagjiatura paraqet shkelje të rëndë, andaj konstatimi i së njëjtës paraqet bazë të mjaftueshme nga përjashtimi nga lënda në fjalë!